

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHPËRBLIM TË
ARSYESHËM NGA RIPRODHIMI I VEPRAVE PËR PËRDORIM PRIVAT OSE PËR
PËRDORIM TJETËR PERSONAL”

I. QËLLIMI I VENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është realizimi i shpërblimit të drejtë të autorit që vjen si pasojë e riprodhimit/kopjimit të pa autorizuar nga autori ose mbajtësi i ligjshëm i të drejtës për përdorim privat ose përdorim tjetër personal. Hartimi i këtij projektvendimi autorizohet nga ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, konkretisht në nenin 31, “E drejta e shpërblimit për riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal”, i ndryshuar si dhe pika 1 e nenit 188 “Aktet Nënligjore”.

Hartimi dhe miratimi i këtij projektvendimi për kopjen private synon të përmirësojë kuadrin ligjor mbi shpërblimin e drejtë të autorit ose mbajtësit të ligjshëm të së drejtës që lidhen me fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet ulja e çenimit të dëmit që i shkaktohet autorit të veprës në rastet kur vepra është riprodhuar pa autorizimin e tij për përdorim privat ose për përdorim tjetër personal.

Ky projektvendim synon gjithashtu të pasqyrojë dhe të përditësojë ndryshimet e vazhdueshme të ndodhura në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, t’i përgjigjet zhvillimeve të teknologjisë dhe digjitalizimit, të korrigjojë dhe të përmirësojë vakumet ligjore dhe t’u vijë në ndihmë krijuesve të të gjitha fushave. Ky projektvendim ka për synim edhe përmirësimin e sistemit të shpërblimit të drejtë në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, duke sjellë për pasojë nxitjen e krijimtarisë së kësaj fushe.

Synimi ndër të tjera i këtij projektvendimi, është të sigurojë rritjen e shpërblimit të titullarëve në një shkallë më të lartë duke sanksionuar detyrimin për të paguar shpërblimin e arsyeshëm, të përmendur në pikën 1, të nenit 31 të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar. Kjo do të sjellë më shumë zbatueshme ri të ligjit, si dhe të ardhura për autorët krijues dhe/ose për mbajtësit e tjerë të së drejtës.

II. VLERËSIMI I VENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KESHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është hartuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare dhe angazhimeve të ndërmarra nga Ministria e Kulturës në kuadrin e hartimit dhe përmirësimit të akteve me fuqi ligjore dhe nënligjore. Hartimi i këtij projektvendimi vjen si pasojë e nevojës për të zbatuar kuadrin ligjor në mënyrë që të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to të respektohen në një shkallë më të gjerë. Ky detyrim lind edhe nga zbatimi

i vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 25.1.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017–2020”, ku në kapitullin 7 parashikohet forcimi i mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Intelektuale dhe sigurimi i një niveli mbrojtjeje, të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Europian, e cila ka qenë një nga angazhimet e Qeverisë Shqiptare parashikuar në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, përkatësisht neni 73.

Miratimi i këtij projektvendimi është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave si dhe detyrimi ligjor në kuadër të zbatimit të ligjit Nr. 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to” pika 1 e nenit 31.

Po ashtu miratimi i këtij akti gjen parashikim edhe në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016-2020.

III. ARGUMENTIMI I VENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Efektet e pritura nga ky projektvendim lidhen ngushtë me të drejtat ekonomike të autorit dhe mbajtësit e tjerë të së drejtës. Duke përfshirë dispozita ligjore të cilat lidhen me përdorimin si kopje private për përdorim personal të veprës/ave në mënyrë masive pa autorizimin përkatës nga titullari i së drejtës pritet që ky projektvendim të rregullojë në mënyrë proporcionale raportet e shpërblimit të autorëve krijues dhe mbajtësve të tjerë të së drejtës, të cilët deri më sot nuk kanë pasur mundësinë të mbledhin shpërblime nga përdorimi/kopjimi/riprodhimi i veprave të tyre duke sjellë indirekt cënimin e të drejtës së autorit për të autorizuar/lejuar përdorimin e veprës së tyre.

Ndërgjegjësimi dhe intensifikimi i mëtejshëm i luftës ndaj shkeljeve të së drejtës së autorit mbetet prioritet i rëndësishëm në të ardhmen, pasi përveç sensibilizimit të subjekteve përdorues, vendi ynë dhe shtetet e tjera ndeshen me zhvillimet e reja të teknologjike. Risia teknologjike nxjerr në pah faktin se dispozitat ligjore parashikuese janë thujse gjithmonë një hap mbrapa formave të ndryshme, të reja, të cënimeve që burojnë si rezultat i teknologjisë. Me këtë projektvendim të propozuar synohet të ketë lehtësi në zbatimin e ligjit mbi shpërblimin e arsyeshëm.

Ky projektvendim reflekton gjithashtu kërkesat ligjore për përcaktimin e listës së pajisjeve dhe tarifave për shpërblim të arsyeshëm, të cilat duhet të paguhet nga importuesit dhe prodhuesit e pajisjeve të cilat mundësojnë çdo përdorues të realizojë kopje të veprave të cilat janë pronë e autorit apo titullarit të drejtave. Në këtë kuadër ekziston pamundësia e tij apo çdo instance ligjore të ngritur me qëllim mbrojtjen e të drejtës së autorit sipas përcaktimeve të ligjit. Projektvendimi synon shpërblimin e autorëve, veprat e të cilëve mund të riprodhohen pa autorizim për përdorim privat ose përdorim tjetër personal. Në projektvendim është përcaktuar se cilët janë subjektet të cilët janë pjesë e këtij detyrimi, si dhe modalitete të tjera të zbatueshmërisë së këtij akti.

IV. VLERESIMI I LIGJSHMERISE, KUSHTETUTSHMERISE DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NE FUQI

Ky projektvendim hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 31 të ligjit Nr. 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to”, i cili ngarkon Këshillin e Ministrave për nxjerrjen e aktit nënligjor.

Për sa i përket çështjes së kushtetutshmërisë së projektvendimit, nga pikëpamja formale ai përbën një akt nënligjor të nxjerrë në respektim të kriterëve të parashikuara nga neni 118 i Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BASHKIMIT EUROPIAN

Ky projektvendim i propozuar është në zbatim të ligjit 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to”. Projektvendimi i hartuar nga strukturat e Ministrisë së Kulturës, në lidhje me përqindjen e vlerës së detyrimit i është referuar vlerave më të ulëta të vendeve të studiuara. Hartimi i këtij projektakti është detyrim që buron nga ligji nr. 35/2016.

Konkretisht, disa prej këtyre vendeve kanë vlera në përqindje, p.sh vlera e vendosur në Rumani është nga 0.5 deri në 7 %, Bullgaria nga 1 deri në 1.5 %.

Vlera e përcaktuar për shtetin Shqiptar është zgjedhur si propozimi më i arsyeshëm, më i ulët i aplikuar në ndonjë vend të rajonit dhe BE, duke pasur parasysh se implementimi i kopjes private është një risi në fushën e të drejtës së autori si dhe atë të tregut shqiptar, e për rrjedhojë, për të mos ndikuar në rritjen e kostove për subjektet importues/prodhues dhe konsumator është vendosur vlera në përqindje sa më e ulët.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË VENDIMIT

Ky projektvendim përmban 6 (gjashtë) kre si dhe 2 (dy) shtojca të cilët përcaktojnë:

Kreu 1 – Në këtë kre përcaktohen përkufizime të reja i tarifës për shpërbllim të arsyeshëm, si dhe përcaktimin e palëve të cilët do të jenë subjekte në zbatim të këtij vendimi, përkufizim i qartë lidhur me prodhuesin vendas dhe importuesin sipas nenit 31 të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, mënyrën

Kreu 2 - Në këtë kre përcaktohet qartazi qëllimi i këtij projektvendimi sipas kushteve të nenit 31 të ligjit për të drejtën e autorit, përkufizimi.

➤ Në pikën 1, të dispozitave të përgjithshme është përcaktuar qëllimi i përgjithshëm i projektvendimit.

- Në pikën 2, të këtij Kreu është përcaktuar se shpërblimi i mbledhur do të paguhet për llogari të Sportelit unik të krijuar sipas nenit 138 të ligjit 35/2016, si dhe bazuar këtij ligji Sporteli Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit -SUADA do të bëjë dhe shpërndarjen.

Kreu III – Në këtë kre përcaktohen pajisjet dhe të gjitha mjetet e tjera që nevojiten për regjistrimin vizual dhe zanor, që bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal. Gjithashtu, jepet mënyra e përlllogaritjes së tarifave të shpërblimit të arsyeshëm bazuar në informacionin e vendosur në dispozicion nga ana e organeve kompetente doganore dhe tatimore, afatet e pagesës të kësaj tarife, dokumentacioni që importuesit dhe/ose prodhuesit vendas duhet të vendosin në dispozicion të Sporteli Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit -SUADA për të lidhur kontratë/marrëveshje.

Kreu III ka përcaktuar detyrimin për shpërblimin nga pajisjet/aparatet dhe suportet/njësitë ose nëpërmjet mjeteve të tjera të reja për regjistrimin vizual dhe zanor.

- Në pikën 1 janë përcaktuar pajisjet dhe të gjitha mjetet e tjera që nevojiten për regjistrimin vizual dhe zanor, që bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal. Lista e pajisjeve specifike që potencialisht mund të përdoren për këtë qëllim janë përcaktuar në shtojca 1 të projektvendimit.
- Në pikën 2 është përcaktuar detyrimi për pagimin e tarifës përkundrejt Sportelit Unik si dhe referenca për mënyrën e shpërndarjes në përqindje, sipas nenit 139 të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.
- Në pikën 3 është përcaktuar masa e tarifës për shpërblim të arsyeshëm për listën e pajisjeve/aparateve dhe për për suportet/njësitë është 0.5 % (përqind).
- Në pikën 4 është përcaktuar mënyra e përlllogaritjes së tarifës e cila bëhet sipas:
 - a) Vlerës doganore të pajisjeve/aparateve dhe suporteve/njësisve riprodhuese që bëjnë të mundur regjistrimin vizual dhe/ose zanor si dhe fiksimin/regjistrimin e tekstit, në analog dhe digjital në muajin për të cilin detyrohet (këtu nuk përfshihet TVSH, taksa doganore dhe akcizat).
 - b) Faturave mujore të lëshuara nga prodhuesit, të pajisjeve/aparateve dhe suporteve/njësisve riprodhuese që bëjnë të mundur regjistrimin vizual dhe/ose zanor si dhe fiksimin/regjistrimin e tekstit, në analog dhe digjital, pa TVSH, të prodhuar në Republikën e Shqipërisë.
- Në pikën 5 përcaktohet periodiciteti për dhënien e informacionit nga strukturat shtetërore Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe organi kompetent tatimor për të vijuar më pas me llogaritjen e pagesës së tarifës së shpërblimit të arsyeshëm. Afati maksimal për pagimin e tarifës do të jetë jo më vonë se 30 ditë nga muaji pasardhës.

Gjithashtu në këtë pikë është përcaktuar detyrimi që ka organi kompetent doganor për importuesit e pajisjeve dhe aparaturave dhe organi kompetent tatimor për prodhuesin e

pajisjeve/aparateve për të vendosur ne dispozicion të Sportelit Unik informacionin e nevojshëm për të përlllogaritur tarifën. Ky informacion konsiston në :

a. (Për importuesin) i deklaratave doganore (import), data e deklaratës doganore, vlera doganore (vlera Statistikore), NIPT-i subjektit importues

b. (Për prodhuesin vendas) në faturat mujore të lëshuara nga prodhuesit vendas, pa TVSH, për çdo pajisje/makineri të prodhuar në Republikën e Shqipërisë, datën e faturës, dhe ën e NUIS të subjekteve prodhuese.

➤ Në pikën 6 parashikohet se shkëmbimi i të dhënave, do të kryhen bazuar në një marrëveshje të lidhur ndërmjet organeve kompetente doganore dhe tatimore dhe ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit.

➤ Pika 7 parashikon se Sporteli Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit (S.U.A.D.A.) është struktura përgjegjëse për të përlllogaritur sipas rastit, tarifatat për shpërblim të arsyeshëm që do të paguhet nga importuesi dhe/ose prodhuesi vendas, shifra të cilat do të përcaktohen në kontratën/marrëveshjen me S.U.A.D.A.-n. Shpërblimi për tu paguar do të llogaritet bazuar me informacionin e shkëmbyer me autoritetet doganore dhe tatimore.

➤ Pika 8 parashikon detyrimin e Sportelit unik, për të shpërndarë dhe llogaritur shpërblimin e arsyeshëm sipas vendimit dhe ligjit për të drejtën e autorit.

Kreu IV përcakton detyrimin për shpërblimin nga pajisjet/makineritë/materialet e reja të fotokopjimit, mënyrën e përlllogaritjes në % (përqindje) të tarifave të shpërblimit të arsyeshëm për mjetet e sipër përmendur.

➤ Pika 1 e kreut III, përcakton se tarifatat për shpërblim të arsyeshëm janë të detyrueshme për tu paguar nga prodhuesit vendas në rastin e shitjes së parë, ose importuesit e çdo pajisje/makinerie tek Sporteli Unik për Administrim të së Drejtës Autorit (S.U.A.D.A.).

➤ Në pikën 2 është përcaktues se lista e pajisjeve/makinerive të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat dhe vetjak ose për përdorim tjetër personal nëpërmjet fotokopjimit në letër ose në çdo teknikë tjetër riprodhimi që njehsohet dhe ka të njëjtin efekt me fotokopjimin. Kjo liste është në shtojcën Nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi.

➤ Në pikën 3 është përcaktuar se tarifatat për shpërblim të arsyeshëm për listën e pajisjeve/makinerive, të përcaktuar në shtojcën Nr. 2, është 0.5 % (përqind), përqindja me ulët ne rajon.

➤ Në pikën 4 është përcaktuar forma e llogaritjes së shpërblimit të arsyeshëm në pajisjet e shtojcën Nr.2, e cila bëhet rast pas rasti sipas:

a) Vlerës doganore për çdo pajisje/makineri të reja të fotokopjimit të importuar.

b) Faturave mujore të lëshuara nga prodhuesit të prodhuar në Republikën e Shqipërisë, pa TVSH, për çdo pajisje/makineri të prodhuar në RSH.

- Pika 5 e këtij kreu referon në pikat 5, 6, 7, 8, 9 të kreut III, të këtij vendimi të cilat zbatohen njësoj edhe për prodhuesit dhe importuesit e pajisjeve/makinerive te reja te fotokopjimit të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat dhe vetjak ose për përdorim tjetër personal.

Kreu V përcakton shpërblimin për produktet zëvendësuese ose pjesë të pajisjeve/materialeve/aparateve të tjera

Kreu VI përcakton institucionet që ngarkohen për zbatim të këtij vendimi që janë Ministria e Kulturës dhe Sporteli Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit (S.U.A.D.A.). Drejtoria e Përgjithshme e Doganave do të përcaktojë kodet tarifore te mallrave të listuara në shtojcën 1 dhe 2.

Projektvendimi është dërguar për mendim Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, ish-Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ish-Ministrisë së Inovacionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Doganave dhe AMA, të cilat janë shprehur:

- ✓ Me shkresën Nr. 1556/1, datë 21.03.2017 Ministria e Drejtësisë është shprehur me vërejtje lidhur mbi këtë projekt akt. Me shkresën Nr.1174, datë 12.05.2017 të Ministrisë së Kulturës, janë reflektuar në projektvendim dhe në relacion, vërejtjet e Ministrisë së Drejtësisë. Me shkresën Nr.1556/3, datë 26.05.2017 Ministria e Drejtësisë i ka konsideruar shteruese argumentet e Ministrisë së Kulturës dhe është shprehur parimisht dakort me këtë projektvendim. Pas ridërgimit për mendim Ministria e Drejtësisë me shkresën 2979/1 prot., datë 19.3.2018 shprehet dakord.
- ✓ Me shkresën Nr. 3130/4, datë 12.04.2017 Ministria e Financave shprehet me sugjerime duke evidentuar faktin se miratimi i këtij projektvendimi do kishte kosto shtesë mbi biznesin duke sjell impakt negativ mbi volumin e importit dhe çmime përfundimtare më pak konkurruese. Me shkresën Nr. 3751, datë 06.06.2017 Ministria e Kulturës ka reflektuar mbi komentet e dhëna nga Ministria e Financave. Konkretisht: Në vijim të sugjerimeve të lëna, Drejtoria për të Drejtën e Autorit e pa të arsyeshme të kërkonte nga WIPO një eksperte të fushës, WIPO e miratoi dhe kontraktoi znj. Romana Vuckovic e cila gjatë takimit të sajë në Tiranë, pasqyroi përqindje të ndryshme të vendeve të rajonit, duke dalë në konkluzion që masa e përqindjes së përcaktuar në shtojcën 1 të projektvendimit për “suporte/njësi” të ndryshohej nga 3 %- në 0.5 %, pra një ulje e konsiderueshme. Kjo masë përqindje është më e ulëta ndër vendet e rajonit të cilët kanë të miratuara tarifatat për kopjen private. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 5166/1 prot., datë 18.4.2018 shprehet parimisht dakord, me nje sugjerim për saktësim në projektvendim i cili është reflektuar.

- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 6202/1 prot., datë 11.4.2018 ka dhënë sugjerime të cilat janë marrë parasysh dhe janë reflektuar në projektvendim dhe relacion
- ✓ Me shkresën Nr. 1439, datë 16.03.2017 ish-Ministria për Inovacionin është shprehur parimisht pa vërejtje dhe parimisht dakort me projektvendimin.
- ✓ Me shkresën Nr. 5475/1, datë 29.03.2017 Drejtoria e Tatimeve është shprehur së në fazën që është duke u hartuar projektvendimi nuk ka komente shtesë pasi në referim të përcaktimeve të projektvendimit marrëdhëniet midis autoritetit tatimor dhe Ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit do të rregullohen me një marrëveshje/ memorandum mirëkuptimi.
- ✓ Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes me shkresën nr. 1215/1 prot., datë 28.3.2018 është shprehur dakord.
- ✓ AMA nuk është shprehur lidhur me këtë projektvendim.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QE NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për shkak të fushës së zbatimit të së drejtës së autorit dhe mbrojtjes, dhe me qëllim realizimin e këtyre ndryshimeve ligjore, institucionet që përfshihen janë, Ministria e Kulturës (nëpërmjet Sportelit Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit – SUADA), Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, si dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut. Këto janë institucionet që ngarkohen për zbatueshmërisë dhe/ose mbikëqyrjen e këtij akti.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E VENDIMIT

Për këtë vendim kanë kontribuar specialistët e Ministrisë së Kulturës duke pasur parasysh se tarifa e kopjes private është një risi për Shqipërinë dhe për pasojë është një tarifë e re shpërblimi për operatorët e Republikës së Shqipërisë. Për të hartuar një projektvendim të ngjashëm me modelet standarte të vendeve të rajonit dhe atyre të Bashkimit Evropian Ministria e Kulturës kërkoi asistencë teknike me ekspertët e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) për të dhënë mendime, sugjerimet e tyre mbi vendet të cilat e kanë implementuar tarifën e shpërblimit të “kopjes private”.

Kërkesa e Ministrisë së Kulturës për misionin e ekspertizës shprehu shumë qartë faktin se duke qenë se vendi ynë synon ta hartojë dhe zbatojë për herë të parë këtë akt, duke qenë se mbetet e rëndësishme mbrojtja e të drejtave të autorit dhe atyre të lidhura me to, sepse ky akt nuk duhet të afektojë funksionimin normal dhe klimën e biznesit vendas dhe të huaj, duke qenë se niveli i

informalitetit dhe piraterisë mbetet problem i përgjithshëm për tu reduktuar, masa e tarifave për kategoritë përkatëse të listuara në shtojcat e këtij projektvendimi duhet të jetë minimaliste.

Kjo politikë konsiderohet e drejtë për nivelin ekonomik-shoqëror të vendit tonë nga njëra anë dhe për të siguruar një balancë të drejtë mes veprimtarisë së subjekteve importues dhe prodhues vendas, konsumatorit të këtyre pajisjeve dhe autorëve nga ana tjetër, që përfaqësohen në administrimin kolektiv nga agjencitë përkatëse të licencuara nga Ministria e Kulturës. Kjo kërkesë edhe si adresim i shkresës së Ministrisë së Financave për kujdesin që duhet të tregohet ndaj klimës së biznesit dhe konsultimit më të gjerë të mundshëm të grupeve të interesit për efekte e këtij projektvendimi.

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (ËIPO) e vlerësoi kërkesën dhe kontraktoi ekspertin, znj. Romana Vuckovic, e cila gjatë misionit të saj në Tiranë, konkretisht, me specialistët e Drejtorisë për të Drejtën e Autorit raportoi mbi tarifën e kopjes private për vendet e rajonit duke i demonstruar me pasqyra vlerat në përqindje si dhe bëri një vështrim krahasues të tarifës së kopjes private me shembuj nga vendet fqinje të Shqipërisë dhe atyre të BE-së me karakteristika të ngjashme me tregun artistik shqiptar, si më poshtë vijon:

➤ Në Bosnjë dhe Hercegovinë, znj. Vuckovic u shpreh se, nuk ekziston asnjë mekanizëm efektiv, apo një sistem funksional për mbledhjen e të ardhurave për mbajtësit e së drejtës. Mbajtësit e së drejtës janë: autorët, interpretuesit, prodhuesit e fonogrameve, prodhuesit e filmave, botuesit, dhe mbledhja e tarifës së kopjes private duhet të bëhet nga Agjencitë e Menaxhimit Kolektiv. Rezulton se asnjë organizatë/agjenci nuk ka mbledhur. Gjithashtu, tarifa e kopjes private përcaktohet nga Këshilli i Ministrave si dhe kriteret për vendosjen e tarifave janë të përcaktuara në legjislacionin për të Drejtën e Autorit, në fuqi. Skema e shpërndarjes: autorët: interpretues: fonogram / prodhuesit e filmit = 40:30:30 autorët: botuesit = 50:50.

➤ Në Bullgari, znj. Vuckovic u shpreh se, nuk ekziston asnjë mekanizëm efektiv, apo një sistem funksional për mbledhjen e të ardhurave për mbajtësit e së drejtës. Mbajtësit e së drejtës janë: autorët, interpretuesit, prodhuesit e fonogrameve, prodhuesit e filmave, botuesit, dhe mbledhja e tarifës së kopjes private duhet të bëhet nga Agjencitë e Menaxhimit Kolektiv. Rezulton se asnjë organizatë/agjenci e menaxhimit kolektiv nuk ka mbledhur.

Gjithashtu, tarifa e kopjes private nuk duhet të jetë më e ulët se 1% dhe jo më e lartë se 1,5%. Skema e shpërndarjes: autorët: interpretues: fonogram / prodhuesit e filmave = 50:25:25 autorët: botuesit = 50:50.

➤ Në Maqedoni nuk ekziston asnjë mekanizëm efektiv, apo një sistem funksional për mbledhjen e të ardhurave për mbajtësit e së drejtës.

Por ka përcaktuar se mbajtësit e së drejtës janë: autorët, interpretuesit, prodhuesit e fonogrameve, prodhuesit e filmave, botuesit, dhe mbledhja e tarifës së kopjes private duhet të bëhet nga

Agjencitë e Menaxhimit Kolektiv. Rezulton se asnjë organizatë/agjenci nuk ka mbledhur të ardhura.

Kompensimi i mbledhur duhet të shpërndahet në mesin e pronarëve të drejtë sipas raportit 40:30:30.

➤ Mali i Zi, znj. Vuckovic u shpreh se, nuk ekziston asnjë mekanizëm efektiv, apo një sistem funksional për mbledhjen e të ardhurave për mbajtësit e së drejtës.

Mbajtësit e së drejtës janë: autorët, interpretuesit, prodhuesit e fonogrameve, prodhuesit e filmave, botuesit, dhe mbledhja e tarifës së kopjes private duhet të bëhet nga Agjencitë e Menaxhimit Kolektiv. Rezulton se asnjë organizatë nuk ka mbledhur të ardhura.

➤ Në Rumani përfituesit janë: autorë, interpretues, botues, fonogram dhe prodhuesit audio vizualë.

Tarifa e prezantuar për vitin 2009 është si vijon:

Për pajisjet 0,5% të çmimit të produktit (pa TVSH) dhe për mediat e magazinimi 3% e çmimit të produktit (pa TVSH).

Në 2014 në Rumani znj. Vuckovic u shpreh se për tarifën e kopjes private, është mbledhur vlera prej 10.000 €.

Shpërndarja e tarifës së mbledhur është përcaktuar si më poshtë:

40% autorë dhe botues;

30% interpretues;

30% për regjistruesit e zërit.

➤ Në Serbi përfituesit janë: autorët, interpretuesit, fonogram dhe prodhuesit e filmave, botuesit. Kompensimi i mbledhur duhet të shpërndahet në mesin e pronarëve të drejtë sipas raportit 40:30:30. Në vitin 2016 HDS dhe SOKOJ (Agjenci Menaxhimi Kolektive) mblodhën rreth 20 300 euro.

➤ Sllovenia - asnjë mekanizëm efektiv në vend.

➤ Në Austri tarifat janë të lidhura me kapacitetin e produkteve, por nuk mund të kalojnë 6% të nivelit "tipik" të çmimeve- tavani për shumën totale të parave të grumbulluara është 20 milion euro në vit, nëse tejkalohet, tarifa duhet të rinegociohet.

➤ Estonia - taksat janë të përcaktuara me ligj si përqindje e vlerës së produktit: 3% për pajisjet regjistruese dhe 8% për mediat e magazinimit. Lista e mediave dhe pajisjeve nuk është përshtatur që nga viti 1996 dhe për këtë arsye taksat e mbledhura janë të barabarta me zero (0).

➤ Greqia - Tarifa është vendosur nga ligji në fuqi si përqindje e çmimit të produkteve (rreth 6% për pajisjet dhe 4% në media). Kompjuterët ende nuk janë përfshirë, sugjerohet që çmimi të jetë 2 %.

➤ Kjo është një pasqyrë e vendeve të rajonit dhe të Bashkimit Europian, pasqyrim i cili tregon në fakt gjendjen e efektivitetit të tarifave të aplikuara në vendet e rajonit. Në fakt hartimi i këtij projektvendim është një detyrim që e imponon ligji në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.

IX. RAPORTI I VLERESIMIT TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Hyrja ne fuqi e këtij vendimi nuk shoqërohet me efekt financiar për buxhetin e shtetit. Tarifat që do të aplikohet për efekt të këtij akti i shpërndahen autorit nëpërmjet Sporteli Unik për Administrim të së Drejtës Autorit (SUADA).

X. HYRJA NE FUQI E KËTIJ VENDIMI

Ky vendim do të hyjë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.